



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/  
PROCUREMENT REVIEW BODY

Në bazë të nenit 102 të Ligjit për Prokurim Publik nr.04/L-042, nenit 12 të Rregullores së Punës së OSHP dhe në bazë të nenit 100, 102 dhe 103 të Ligjit për Procedurë Administrative u.d.së Kryetarit të OSHP-ës me datë 03.02.2016 nxjerr këtë:

**VENDIM**

Shpallet i pavlefshëm vendimi nr.712/15 i datës 17.09.2015 dhe plotësim vendimi nr.877/15 i datës 04.12.2015.

**ARSYETIM**

Bordi i OSHP-ës me datë 17.09.2015 nxjerr vendim me nr.712/15 mbi procesin e shqyrtimit të ankesave dhe plotësimin e këtij vendimi me datë 04.12.2015 me nr.877 me qëllim të konkretizimit të nenit 111 të LPP-ës, mirëpo gjatë procesit të implementimit të tyre kemi hasur zbrasia juridike, si dhe duke pas parasysh faktin se është bërë plotësim ndryshimi i Ligjit të Prokurimit Publik nr.04/L-042, u.d.së Kryetarit të OSHP-ës vendosi që vendimet e sipër theksuar të shpallen të pa vlefshme.

Ky vendim hynë fuqi ditën e nënshkrimit.

